



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 29.7.2024, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE KOMPANISË PËR MENAXHIMIN E**  
**DEPONIVE NË KOSOVË (KMDK) SHA**

1. Miratohet ndarja e mjeteve financiare KRM-së "Pastrimi", SHA.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, shuma e mjeteve që ndahet është në vlerë prej 200,000.00 € (dyqind mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria "subvencione dhe transfere" - Drejtoria e Administratës.
3. Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për mbulimin e borxhit që KRM "Pastrimi", SHA, ka ndaj KMDK-së për grumbullimin e mbeturinave në këtë deponi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit dhe Drejtoria e Financave.
5. Obligohet KRM "Pastrimi", SHA, që mjetet e ndara si në pikën 2 të këtij Vendimi, t'i destinojë specifikisht dhe vetëm për pagimin e borxhit që ka ndaj KMDK-së, si dhe të njoftojë menjëherë Komunën e Prishtinës për një veprim të tillë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-400/04-99469/24, më 31.7.2024

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina

